



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-493

Në bazë të nenit 21 të ligjit Nr. 04/1-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të ligjit Nr. 04/1-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44, dhe 84 të ligjit Nr. 05/1-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika “d” të ligjit Nr.03/1-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, duke vendosur sipas kërkesës me nr. 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023, të pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të “Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore me nr 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”, lëshuar nga kjo drejtori, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit në Çagllavicë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me dt. 29.09.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLOTËSIMIT DHE NDRYSHIMIT TË AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE 05 NR. 350-271083 TË DT. 25.01.2017”

I. Miratohet kërkesa 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023, në emër të pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, për ndryshimin/plotësimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”, nga Drejtoria e Urbanizmit.

II. Ndryshohet dhe plotësohet “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në emër të pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, si Fazë e parë e ndërtimit, i përbërë prej 120 (një qind e njëzetë) shtëpive individuale të banimit, e planifikuar në 6 tipe të shtëpive - Tipi “A”, “B”, “C”, “D”, “E” dhe “G”, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1285-1, 1287-1, 1288-0, 1291-1, 1292-1, 1292-2, 1292-3, 1292-4, 1292-5, 1292-6, 1292-7, 1292-8, 1293-1, 1293-2, 1293-3, 1293-4, 1293-5, 1293-6, 1293-7, 1293-8, 1294-1, 1294-2, 1294-3, 1294-4, 1294-5, 1294-6, 1294-7, 1294-8, 1295-1, 1295-2, 1295-3, 1295-4, 1295-5, 1295-6, 1295-7, 1295-8, 1295-9, 1295-10, 1295-11, 1295-12, 1295-13, 1295-14, 1295-15, 1295-16, 1296-1, 1296-2, 1296-3, 1296-4, 1296-5, 1296-6, 1296-7, 1296-8, 1296-9, 1296-10, 1297-7, 1297-8, 1297-9, 1297-10, 1298-2, 1298-3, 1298-4, 1298-5, 1298-6, 1298-7, 1298-8, 1298-9, 1298-10, 1298-11, 1298-12, 1298-13, 1298-14, 1298-15, 1298-16, 1298-17, 1298-18, 1298-19, 1298-20, 1298-21, 1298-22, 1298-23, 1298-24, 1298-25, 1298-26, 1298-27, 1298-28, 1298-29, 1298-30, 1298-31, 1298-32, 1298-35, 1298-36, 1298-37, 1298-38, 1298-41, 1298-42, 1298-43, 1298-44, 1298-47 ZK. Çagllavicë.

Plotësimi dhe ndryshimi bëhet në pikën I. dhe IV. Të “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017” dhe pjesës grafike-situacioni të këtyre kushteve, dhe ka të bëjë me:

- I largimi i 2 shtëpive të tipit “A”, të planifikuara sipas kushte ndërtimore, në parcelat kadastrale me nr. 1773-3 dhe 1773-4 ZK. Çagllavicë, si dhe zëvendësimin e tyre me ndërtesë “afariste” me etazhitet B+P+1, që do shërbej në shërbim të kompleksit.
- ISHP- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës i lejuar është max. 30%, ndërsa sipas Vendimit nr.01-031-185481 dt. 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës për zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme lejohet deri në 40% (vendim të cilin pala e ka propozuar për aplikim);

5-703X0.4-301.2 m² / sipas vendimit nr.01-031-185481 dt. 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës për zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme/
S=359.13 m² sipas Projekt Propozimit.

- Bazuar në kushtet e caktuara me këtë plotësim ndryshim të hartohet dokumentacioni ndërtimor ku përveç kërkesave që janë shënuar në pikën IX të “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”, projekti kryesor duhet të përmbajë edhe kushtet e veçanta ndërtimore sipas pikës 4. dhe 5. të Vendimit nr.01-031-185481 dt. 14.08.2015 të Kryetarit të Komunës për zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme për të cilat duhet të punohet edhe elaborat:

III. Bashkimi i parcelave kadastrale nr. 1773-3 dhe 1773-4 ZK. Çagllavicë, për krijimin e parcelës ndërtimore të bëhet duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin/ndarjen e parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të bashkimit të parcelave, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit/ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtij vendimi dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Plani i situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeometri i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV. Me këtë Vendim Ndryshohen dhe Plotësohen Kushtet Ndërtimore të miratuara me “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017, për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Kërkuesit Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, me kërkesën 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, të Komunës së Prishtinës, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, në emër të pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, si Fazë e parë e ndërtimit, i përbërë prej 120 (një qind e njëzetë) shtëpive individuale të banimit, e planifikuar në 6 tipe të shtëpive - Tipi “A”, “B”, “C”, “D”, “E” dhe “G”, në lokacionin e përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar:

- Kopjet e planit dhe fletat poseduese për parcelën kadastrale nr. 1773-3 dhe 1773-4 ZK. Çagllavicë, të evidentuar në certifikatat e njësisë kadastrale P-71914075-01773-3 dhe P-71914075-01773-4;
- Informimin nga Plani Zhvillimor Komunal-PZHK nr. 2427 dt. 11.09.2019;
- Aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017”;
- Aktin administrativ “Vendimin për lejimin e ndërtimit nr. 05 NR. 351/02-0247279/17 DT. 06.05.2019” të kompleksit të shtëpive individuale për banim, lëshuar nga kjo Drejtori;
- “Kontrata mbi ndërtimin e përbashkët të kompleksit ndërtimor” e lidhur në mes të pronarit Fatmir Sallahu nga Vushtrria dhe investitorit “Neë Prishtina Residence” shpk, me seli në Prishtinë, me numër të biznesit 70883104, e vërtetuar te noterja Merita Kostanica Ukaj Nr. 1RP.5826/2020 Nr. REF. 1448/2020 (kopje);
- Projektin ideor për ndërtesën afariste së bashku me dokumentacionin juridik të kompanisë projektuese NPN “GM ARCHITECTURE”, me seli në Prishtinë, me certifikatën e regjistrimit të biznesit nr. 810061466;

- Incizimin gjeodezik i parcelës kadastrale me pozicionim te objektit të planifikuar, punuar nga "Geo Horizont" shpk, me numër të licencës 54.
- Vërtetimet nga Drejtoria e Financave për tatim në pronë,
- Kopjet e dokumenteve identifikuese të pronarëve;

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Planin Zhvillimor Komunal-PZHK, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual - projektit ideor, me planin e situacionit - "zgjidhja urbane", ka konstatuar se:

Drejtoria e Urbanizmit duke vendosur, sipas kërkesës nr. 05-035-156431 dt. 16.07.2015 për rishqyrtim të lëndës nr. 05-350-271083 dt. 04.12.2014 dhe Vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës, Nr. A-235/15 dt. 25.04.2016 për shfuqizimin e Vendimit të refuzimit të 05-035-156431 dt. 18.09.2015 të kësaj Drejtorie, pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina me Aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017", janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale të banimit, si Fazë e parë e ndërtimit, i përbërë prej 120 (një qind e njëzetë) shtëpive individuale të banimit, e planifikuar në 6 tipe të shtëpive - Tipi "A", "B", "C", "D", "E" dhe "G", në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1285-1, 1287-1, 1288-0, 1291-1, 1292-1, 1292-2, 1292-3, 1292-4, 1292-5, 1292-6, 1292-7, 1292-8, 1293-1, 1293-2, 1293-3, 1293-4, 1293-5, 1293-6, 1293-7, 1293-8, 1294-1, 1294-2, 1294-3, 1294-4, 1294-5, 1294-6, 1294-7, 1294-8, 1295-1, 1295-2, 1295-3, 1295-4, 1295-5, 1295-6, 1295-7, 1295-8, 1295-9, 1295-10, 1295-11, 1295-12, 1295-13, 1295-14, 1295-15, 1295-16, 1296-1, 1296-2, 1296-3, 1296-4, 1296-5, 1296-6, 1296-7, 1296-8, 1296-9, 1296-10, 1297-7, 1297-8, 1297-9, 1297-10, 1298-2, 1298-3, 1298-4, 1298-5, 1298-6, 1298-7, 1298-8, 1298-9, 1298-10, 1298-11, 1298-12, 1298-13, 1298-14, 1298-15, 1298-16, 1298-17, 1298-18, 1298-19, 1298-20, 1298-21, 1298-22, 1298-23, 1298-24, 1298-25, 1298-26, 1298-27, 1298-28, 1298-29, 1298-30, 1298-31, 1298-32, 1298-35, 1298-36, 1298-37, 1298-38, 1298-41, 1298-42, 1298-43, 1298-44 dhe 1298-47 ZK Çagllavicë, sipas së cilave kushte është miratuar edhe zgjidhja urbane për ndërtimin e kompleksit,

Pronaret pas rregullimit të parcelave në fjalë sipas "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017", dhe krijimit të parcelave sipas zgjidhjes urbane me kërkesën nr. 05 nr. 351/02-0247279/17 dt. 03.10.2017, kanë kërkuar nga kjo Drejtori lejimin e ndërtimit të kompleksit të shtëpive në fjalë, ku bazuar në kërkesë kjo drejtori me Aktin administrativ "Vendimin për lejimin e ndërtimit nr. 05 NR. 351/02-0247279/17 DT. 06.05.2019", pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, me investitor "ADA Consulting Group" sh.p.k. me seli ne Prishtinë, me nr. të certifikatës së regjistrimit te biznesit 70529610, ju ka lejuar ndërtimin e kompleksit të shtëpive individuale për banim, 120 shtëpi gjegjësisht, 38 shtëpi te tipit "A" prej te cilave 27 me etazhitet P+1 dhe 11 tjera B+P+1, 34 shtëpi te tipit "B" prej te cilave 25 me etazhitet P+1 dhe 9 tera B+P+1, 26 shtëpi te tipit "C" prej të cilave 19 me etazhitet P+1 dhe 7 tjera B+P+1, 12 shtëpi të tipit "D" prej të cilave 8 me etazhitet P+1 dhe 4 tjera B+P+1, 9 shtëpi te tipit "E"- shtëpi dyshe me etazhitet P+1, si dhe 1 shtëpi te tipit "G" me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal- PZHK, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale rr. 1292-2, 1292-3, 1292-4, 1292-5, 1292-6, 1292-7, 1292-8, 1293-2, 1293-3, 1293-4, 1293-5, 1293-6, 1293-7, 1293-8, 1294-2, 1294-3, 1294-4, 1294-5, 1294-6, 1294-7, 1294-8, 1295-3, 1295-4, 1295-5, 1295-6, 1295-7, 1295-8, 1295-9, 1295-10, 1295-11, 1295-12, 1295-13, 1295-14, 1295-15, 1295-16, 1296-1, 1296-2, 1296-3, 1296-4, 1296-5, 1296-6, 1296-7, 1296-8, 1296-9, 1296-10, 1297-7, 1297-8, 1297-9, 1297-10, 1298-2, 1298-3, 1298-4, 1298-5, 1298-6, 1298-7, 1298-8, 1298-9, 1298-10, 1298-11, 1298-12, 1298-13, 1298-14, 1298-15, 1298-16, 1298-17, 1298-18, 1298-19, 1298-20, 1298-21, 1298-22, 1298-23, 1298-24, 1298-25, 1298-26, 1298-27, 1298-28, 1298-29, 1298-30, 1298-31, 1298-32, 1298-35, 1298-36, 1298-37, 1298-38, 1298-41, 1298-42, 1298-43, 1298-44, 1773-3, 1773-4, 1773-5, 1773-6, 1773-7, 1713-8, 1773-9, 1773-10, 1773-11, 1773-12, 1773-13, 1773-

11, 1774-12, 1774-13, 1774-14, 1774-15, 1774-16, 1774-17, 1774-18, 1774-19, 1774-20, 1774-21, 1774-22, 1774-23 dhe 1774-24 ZK. Çagllavicë.

Në ndërkohë në këtë drejtori është pranuar kërkesa nr. 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023, në emër të pronarëve Arian Uka dhe Pleurat Uka nga Prishtina, për ndryshimin/plotësimin e kushteve ndërtimore të caktuara me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350-271083 të dt. 25.01.2017", përkatësisht largimin e dy shtëpive të banimit për parcelat kadastrale 1773-3 dhe 1773-4 ZK. Çagllavicë, të njëjtat të planifikuara me kushtet ndërtimore të cekura më lartë dhe të pajisura me leje ndërtimore me Aktin administrativ "Vendim për lejimin e ndërtimit nr. 05 NR. 351/02-0247279/17 DT. 06.05.2019", duke planifikuar bashkimin e këtyre dy parcelave në një parcelë ndërtimore dhe ndërtimin e ndërtesës afariste, me etazhitet B+P+1, në shërbim të kompleksit me shtëpi të banimit. Ndërtesa afariste në fjalë është planifikuar të ketë sipërfaqen prej 1077.39 m2 ndërtim, prej tyre 718.26 m2 mbi tokë dhe 359.13 m2 nëntokë, ndërsa shfrytëzimi i parcelës ISHP nga 30% sa është e lejuar është planifikuar 39.8%, duke aplikuar Vendimin nr.01-031-185481 dt. 14.08.2015 e Kryetarit të Komunës për zhvillimin e arkitekturës së qëndrueshme.

Pas analizimit të Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013 dhe nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", me datë 27.06.2023 është vendosur afishja "Njoftimi publik" në vende të dukshme të lokacionit, e cila ka qëndruar gjerë me datë 12.07.2023, ku sipas rregullativës ligjore të lartë cekur para caktimit të kushteve ndërtimore, publiku i rrethinës informohet me synimin e kërkesave dhe ju ofrohet mundësia e dhënies së komenteve duke përfshi edhe pronarët / poseduesve të parcelave kadastrale të rrethinës në diametrimin e dritës prej 50m'. Gjatë kësaj periudhe, gjegjësisht datave të lartë shënuara në postën elektronike të vendosur në afishen e njoftimit publik nuk kanë arritur koment nga publiku e as nga pronarët e parcelave kadastrale që kufizohen me këtë kompleks.

Ky organ, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe provave të bashkëngjitura, identifikimit të gjendjes faktike në terren, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore në fuqi, nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, vendosi të miratojë ndryshimet e bëra, sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Shtojcë: Situacioni i ngushtë, me plotësimet dhe ndryshimet e miratuara dhe manuali gjeodezik.

Shtojcë: Dispozita urbanistike-"zgjidhja urbane" me ndërtesa të planifikuara dhe situacioni me vijë rregullues dhe ndërtimore me parcelë kadastrale në Sistemin Koordinativ KOSOVAREF 01.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPHI-së.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05-350-271083 dt. 04.12.2014 dhe 05-350/02-61721/23 dt. 22.03.2023.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-61721/23 DT. 29.09.2023


Zyrtari,
Mimoza Berisha Prestreshi



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazifë Krëniqi



Faqe 4 prej 4



Vija ndërtimore
 Rruge kodastrolle
 Rrugët e logjes



B1 biznes mbi parcelat nr.
 1773-3 dhe 1773-4 (903m²)
 B1 total ndërtim S=1,077.39m²
 Mbi tokë S=718.26m²

Total gjelbërim 290m²
 Gjelbërim 33m²
 Gjelbërim në kullm 340m² x 10% 34m²

Emri i projektit:
 Biznesi i Logjes
 PRLAM Village Prishtina

Pozitimi:
 New Prishtina Residence

Skeda projektuese:
GM
 Street Hold Zgjedhur
 10000 Prishtinë, Kosovë
 +3834545750 | 04547512
 info@gmprojectshqip.com

PROJEKTUESIT:

Mirnoza Haxhija Msc Ark

Lulzim Gashi Ark.
 Jetlira Hysenaj Ark.

KONTROLLOR:

Atden MEHA Ido.

Nazmi Projekt: 2023

Emërtimi i logjes:
 © GM Architecture

Faza e Projektit:
 Projekti ideor/Arkitectura

Emri i Vizatorit:

Titulli i Vizatorit: **Siti ngushte**, Planvendosja e

Vizimi: **Biznesi**, Data: Qershor 2023

Skala: P=1:200

Formati i files: ISO_A3

Nr. i files: 2



PRISHTINA RESIDENCE
PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM I LAGJËS, "Hasan Prishtina" ÇAGLLAVICË, PRISHTINË

TTULLI PROJEKTI


LEGJENDA

- Kufiri i lagës "Hasan Prishtina"
 - Kufiri i parcelës për llogarë ndërtimore
 - Vija ndërtimore
 - Perimetri i parkimit të lagës
 - Rrugët kalimtare
 - Komunikimet, ujë dhe gaz
 - Perimetri i kornizës
 - Hapësira e parkimit rezervuar gjatë rrugës
 - Rrugët e lagës 5*2ha kusht
- TIPET E SHTËPIVE**
- Tipi A: 5x15m, 38 shpatë, parcelë min. 380m²
 - Tipi B: 5x15m, 34 shpatë, parcelë min. 380m²
 - Tipi C: 5x18m, 36 shpatë, parcelë min. 420m²
 - Tipi D: 5x18m, 42 shpatë, parcelë min. 500m²
 - Tipi E (qendra): 5x15x27m, 9 shpatë, parcelë min. 373m²
 - Tipi G: 5x15m, 8 kope
- Skema dhe legjenda të kësaj dokumenti janë pjesë e projektit dhe të drejtat e autoritetit të kësaj dokumenti janë të rezervuara.



SMART ARCHITECTURE
 STUDIO PËR PROJEKTIM ARCHITETURAL DHE INZHINIERË
 Rr. Agim Ramadani 52/B, 10000 Prishtinë, Kosovë
 www.smartarchitecture.com | info@smartarchitecture.com
 +381 452222 00 | +381 45 185 185 | +381 45 143 130

| | |
|-------------|------------------------|
| PROJEKTOR: | Ilirija Shabani Id. |
| PREROR: | Preror Haxhiu, PK Ark. |
| KONTROLLOR: | Lidrim Gashi Ark. |
| APROVOJË: | Artan Pllaha Id. |

| | |
|-------------------|------------------------------------|
| NUMRI I PROJEKTI: | PRISHTINA |
| EMRI I VIZATIMIT: | Situacioni_Planvendosja_e_shtëpive |
| FORMATI I LETES: | ISO A2 |
| PROJEKTI: | P=1:200, 1:1500 |
| NUMRI I LETES: | MARS 2017 |
| DATA: | 08 |



Projekt i lartshprehur në planin e rregullimit






Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1773-3
1773-4

Zona kadastrale / Katastarska zona: Çagllavicë Numri i lëndës / Broj predmeta: 2023

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcelë Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500



| Nr. | Y | X | Text |
|-----|-------------|-------------|--------------------------------|
| 1 | 7510980.240 | 4720645.266 | Propozim për bashkim parcelave |
| 2 | 7510969.876 | 4720658.079 | Propozim për bashkim parcelave |
| 3 | 7510959.662 | 4720670.775 | Propozim për bashkim parcelave |
| 4 | 7510978.430 | 4720688.379 | Propozim për bashkim parcelave |
| 5 | 7510989.927 | 4720677.288 | Propozim për bashkim parcelave |
| 6 | 7511001.939 | 4720665.760 | Propozim për bashkim parcelave |

| Parcelat kadastrale | Sipërfaqe m² | Parcela e propozuar | Sipërfaqe m² e propozuar |
|---------------------|--------------|---------------------|--------------------------|
| 1773-3 | 476 | XXXX-0 | 903 |
| 1773-4 | 427 | | |

Rilevoi / Snimio: "Geo Horizont" SH.P.K.
(entri dhe mbledhësi i gjedete/kompanisë/ime i prezime gjedeta/kompanisë)

Aprovoi / Usvojio: _____
(entri dhe mbledhësi i përsosët zyrtar/ime i prezime shërbenog tica)

Nr. i licencës / Br. licence: 54

Nënshkrimi / Potpis: _____

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 05.09.2023

